



## ÇMIMET DHE TREGJET E PRODUKTEVE BUJQËSORE

Të dhëna bazike të lëndës	
<b>Njësia akademike:</b>	Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit
<b>Titulli i lëndës:</b>	Çmimet dhe Tregjet e Produkteve Bujqësore
<b>Programi:</b>	Agrobiznes
<b>Niveli:</b>	Bachelor
<b>Statusi lëndës:</b>	Obligative (O)
<b>Viti i studimeve:</b>	Viti 3 / Semestri 5
<b>Numri i orëve në javë:</b>	2 + 2
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	6 ECTS
<b>Koha / lokacioni:</b>	Do të shpallet
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	Prof. Asoc. Dr. Kushtrim Braha
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	kushtrim.braha@uni-prizren.com; +383 49 531 537
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Ky kurs është i dizajnuar t'i shërbej studentëve si hyrje në njohjen e tregjeve bujqësore dhe strategjitë e vendosjes së çmimeve. Ky kurs shqyrton modelet e tregjeve në konkurrencën e plotë (kërkesa, oferta, gjendja e ekuilibrit), konkurrencën jo të plotë (monopoli, oligopoli, konkurrenca monopolistike, teoria e lojës, përqendrimi i tregut), përcaktimin e çmimit në struktura të ndryshme të tregut dhe diskriminimin e çmimit. Njëkohësisht, lënda trajton edhe faktorët që përcaktojnë çmimet e produkteve bujqësore, metodat e përcaktimit të çmimeve të produkteve bujqësore, marzhet e marketingut, cilësinë dhe roli e saj në vendosjen e çmimit, sistemet e menaxhimit të cilësisë në bujqësi, variacionin e çmimit në kohë dhe hapësirë dhe teknikat e kërkimit dhe analizës së sjelljes së konsumatoreve.</p>
<b>Qëllimi i lëndës:</b>	<p>Qëllimi i këtij kursi është t'i mësoj studentët me funksionimin e tregjeve në kushtet e konkurrencës së plotë dhe asaj jo të plotë, përfshirë të gjitha strukturat përkatëse të tregut, duke vënë theksin tek konkurrenca jo e plotë si një strukturë mbizotëruese në praktikë. Kjo lëndë u ofron studenteve njohuri bazë edhe mbi disa elemente jo shumë të njohur për ata, siç janë tregjet e së ardhmes, teoria e lojës dhe teknikat e analizës së sjelljes së konsumatorëve.</p>
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<p>Pas përfundimit të kursit, studentët do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Njohin të gjithë elementët që ndikojnë dhe duhet të merren parasysh në përcaktimin e çmimit të produkteve bujqësore.</li><li>▪ Identifikojnë dhe kuptojnë format e ndryshme të strukturave të tregut.</li><li>▪ Njohin metodat e ndryshme të vendosjes së çmimit, si dhe për tu trajnuar të përcaktojnë se cila metodë mund të përdoret në kushte të veçanta.</li><li>▪ Kuptojnë logjikën e variabilitetit të çmimit në kohë dhe hapësirë.</li><li>▪ Kuptojnë tregjet e së ardhmes dhe avantazhet e tyre në drejtim të uljes së rreziqeve të tregut.</li><li>▪ Kuptojnë filozofinë e sjelljes së konsumatorit dhe teknikat themelore për të analizuar këtë sjellje.</li></ul>



Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	3	3
Kontaktet me mësimdhënësin (konsultimet)	1	15	15
Ushtrime në teren	1	3	3
Kollokviume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	13	13
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	8	16
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	2	2	4
Projektet, prezentimet etj.	2	1	2
<b>Totali</b>			<b>150 orë (6 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime, diskutime, konsultime, projekte kursi, detyra shtëpie, kollokviume, provimi përfundimtar.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vijueshmëria e rregullt dhe aktive: 10%,</li> <li>▪ Provimi i ndërmjetëm (kollokviumi): 20%,</li> <li>▪ Projekti i kursit: 10%,</li> <li>▪ Provimi final: 60%.</li> </ul>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura primare:</b>	<p>Hudson D. (2007). Agricultural markets and prices. Blackwell Publishing.</p> <p>Tomek W. dhe Robinson K. (2003). Agricultural product prices, Cornell University Press, 4th ed.</p> <p>Ferries J. (1998). Agricultural prices and commodity market analysis. WCB – McGraw-Hill, New York.</p>		
<b>Literatura shtesë:</b>	Varian H. (1992). Microeconomic analysis. third edition. WW Norton and Company, New York.		

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<b>Java e parë:</b>	Hyrje në tregjet e produkteve bujqësore.	Shpërndarja e temave të projekteve seminarike.
<b>Java e dytë:</b>	Raporti ndërmjet kërkesës dhe çmimit të produkteve bujqësore në kushtet e konkurrencës së plotë.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së parë të ligjëratave.
<b>Java e tretë:</b>	Raporti ndërmjet ofertës dhe çmimit për produktet bujqësore në kushtet e konkurrencës së plotë.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së dytë të ligjëratave.



<i>Java e katërtë:</i>	Monopoli dhe diskriminimi në çmim.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së tretë të ligjëratave.
<i>Java e pestë:</i>	Oligopoli dhe teoria e lojës në kushtet e konkurrencës jo të plotë.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së katërtë të ligjëratave.
<i>Java e gjashtë:</i>	Konkurrenca monopolistike në kushtet e konkurrencës jo të plotë.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së pestë të ligjëratave.
<i>Java e shtatë:</i>	Karakteristikat dhe faktorët determinues të çmimeve bujqësore.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së gjashtë të ligjëratave.
<i>Java e tetë:</i>	Provimi i ndërmjetëm (Kollokviumi).	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së shtatë të ligjëratave.
<i>Java e nëntë:</i>	Metodat e përcaktimit të çmimeve të produkteve bujqësore.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së tetë të ligjëratave.
<i>Java e dhjetë:</i>	Marzhet e marketingut dhe diferencat e çmimeve të lidhura me cilësinë.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së nëntë të ligjëratave.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Variacioni i çmimit në hapësirë dhe kohë.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së dhjetë të ligjëratave.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Raportet e çmimeve në tregjet e të ardhmes për produktet bujqësore.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së njëmbëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Teknikat e kërkimit dhe analizës së sjelljes së konsumatorëve.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së dymbëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Politikat qeveritare dhe ndikimi i tyre në vendosjen e çmimeve të produkteve bujqësore.	Detyra kursi, kuize dhe raste studimore të zgjedhura nga tema e javës së trembëdhjetë të ligjëratave.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimi i projekteve semestrale.	Prezentimi i projekteve semestrale.

#### Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

- Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe Kodin e etikës.
- Studenti duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm.
- Studenti posedojë dhe paraqesë ID kartën në provime e ndërmjeme dhe provime përfundimtare,
- Gjatë hartimit të projekteve të kursit, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimet e dhëna nga mësimitdhënësi.
- Gjatë orës së provimit është i ndaluar përdorimi i celularëve.